



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

DATA/DATUM/DATE:	20.11.2019
PËR/ZA/TO:	Z. Naim Bardiqi – Sekretar i përgjithshëm i MSH, Z. Basri Sejdiu, Drejtor i përgjithshëm i SHSKUK, Z. Shefqet Mrasori, Drejtor i QKSUK-së, Z. Fatmir Plaqiqi Drejtor i FSSH.
NGA/OD/FROM:	Prof. Dr. Blerim Kamberi, Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për kategorizimin e stomatologëve në specializim në pajtim me Ligjin për pagat në sektorin publik

Të nderuar,

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për pagat në sektorin publik nr. 06/L-111., i cili në kategorizimin e pagave merret parasysh parimi i barazisë i vendosur tashmë në ligjin për pagat (Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 3), sipas të cilit “*secili përfitues i pagës merr pagë të barabartë për punën në funksionin, pozitën apo gradën e njejtë apo të krahasueshme*”

Bazuar në Ligjin e aprovuar 06/L-111, kategorizimi i stomatologëve në specializim nuk figuron në kategorinë H7, ku në këtë kategori janë mjekët në specializim, pra është një gabim teknik, këto kategori janë të profilit të njejtë profesional.

Prandaj duke pasur parasysh këtë, bazuar në Ligjin e aprovuar 06/L-111 në nenin 32 të këtij ligji kërkojmë nga ana e juaj që t’i drejtoheni Ministrisë së Administratës Publike me kërkesën që të bëhet ekuivalentimi i stomatologëve me pozitën H7 në të cilën mungojnë stomatologët në specializim

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj

Prof. Dr. Blerim Kamberi

Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës

